



V E N D I M
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot në datë 03 03.2005, unë gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë
A. Coco, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Z.
Artan Maku, për regjistrimin si person juridik të shoqatës
“ **KRIJUESIT E ANIMACIONIT SHQIPTAR** ” (ALBANIMATION) dhe

K O N S T A T O V A

Se kërkuesi Z. Artan Maku me cilësinë kryetarit të shoqatës kërkon të regjistrojë si person juridik shoqatën “ **KRIJUESIT E ANIMACIONIT SHQIPTAR** ” (ALBANIMATION) qëllimi i së cilës sipas statutit dhe aktit themeltar të nënshkruar nga të gjithë anëtarët themelues është :

Shoqata ka si qëllim të saj:

- Të mbrojë krijuesit si ndërmjetëse, për të vendosur një klimë mirëkuptimi në mes të artistëve të animacionit dhe institucioneve shtetërore e private dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë demokratike.
- Të evidentojë vlerat artistike, kulturore si brenda dhe jashtë vendit.
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme që promovojnë këto vlera, të organizojë për këtë qëllim seminare dhe të realizojë trajnimin e artistëve për të vepruar në këtë fushë
- Në aspektin e propogandimit dhe të evidentimit të vlerave artistike do të nxjerre herë pas here fletëpalosje promovuese.
- Të ndërtojë lidhje bashkëpunimi dhe veprimi me shoqata të ndryshme homologe të saj në botë.
- Shoqata vë në dispozicion kontributin e vet me rekomandime e konsulencë për çështje të ndryshme për organizmat kulturore, lokale dhe rajonale .
- Shoqata është e vlefshme në debatime,shkëmbime pikepamjesh dhe arritje konsensusi në formën e një politike më të gjërë kulturore.
- Të marrë përsipër procedura ligjore për të plotësuar dhe mbrojtur interesat e saj.
- Shoqata nuk do të ndjekë qëllime politike apo ekonomike. Ajo është organizatë jofitimpruese dhe joqeveritare dhe synon të mbështesë dhe të bashkëpunojë me të gjithë artistët, krijuesit e filmit të animuar dhe më gjërë për të përmirësuar zhvillimin e filmit të animuar dhe për të dhënë ndikimin e duhur në këtë zhvillim.
- Për zhvillimin sa më të mirë të këtij objekti ajo do të organizojë edhe programe të përbashkëta me shoqata të tjera që kanë lidhje me veprimtarinë.
- Aktivizimin e një grupi të kualifikuar artistësh i cili do të jetë burim i vazhdueshëm konsulence në fushën e filmit dhe të programeve të ndryshëm ku përfshihet animacioni.



- Shoqata me anë të përfaqësuesve të saj do të ndikojë në përzgjedhjen e projekteve fitues të organizuar nga Qendra Kombëtare Kinematografike.
- Përfaqësuesi i kësaj shoqate do të jetë pjesëtar i bordit artistik të mbledhur nga Qendra Kombëtare Kinematografike; përfaqësuesi duhet të jetë krijues i mirënjohur me një aktivitet të plotë në filmin e animuar, për t'u prezantuar denjësisht në bordin artistik të Qendrës kombëtare Kinematografike.

Shoqata me anë të krijuesve me përvojë mund të organizojë kurse kualifikimi për të gjithë që shprehin dëshirën për të patur njohuri mbi filmin e animuar, mbi animacionin në 2D dhe 3D (dy dhe tre dimensional).

Selia e shoqatës do të jetë në Tiranë, Rruga Aleksandër Moisiu, Nr. 76

Kohëzgjatja e saj është me afat të pacaktuar.

Kryetar i shoqatës është zoti Artan Maku

Nisur nga gjithë sa më lart duke u bazuar në dokumantacionin e paraqitur kërkesa është e drejtë e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar

PER KETO ARSYE

Në bazë të ligjit 8788 dhe 8789 datë 07.05.2001 si dhe ligjit 8781 datë 03.05.2001

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës.

Regjistrimin si person juridik te shoqatës

“ KRIJUESIT E ANIMACIONIT SHQIPTAR ”, (ALBANIMATION)

Shoqata ka si qëllim të saj:

- Të mbrojë krijuesit si ndërmjetëse, për të vendosur një klimë mirëkuptimi në mes të artistëve të animacionit dhe institucioneve shtetërore e private dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë demokratike.
- Të evidentojë vlerat artistike, kulturore si brenda dhe jashtë vendit.
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme që promovojnë këto vlera, të organizojë për këtë qëllim seminare dhe të realizojë trajnimin e artistëve për të vepruar në këtë fushë
- Në aspektin e propogandimit dhe të evidentimit të vlerave artistike do të nxjerrë herë pas here fletëpalosje promovuese.
- Të ndërtojë lidhje bashkëpunimi dhe veprimi me shoqata të ndryshme homologe të saj në botë.
- Shoqata vë në dispozicion kontributin e vet me rekomandime e konsulenceë për çështje të ndryshme për organizmat kulturore, lokale dhe rajonale .
- Shoqata është e vlefshme në debatime,shkëmbime pikepamjesh dhe arritje konsensusi në formën e një politike më të gjërë kulturore
- Të marrë përsipër procedura ligjore për të plotësuar dhe mbrojtur interesat e saj.
- Shoqata nuk do të ndjekë qëllime politike apo ekonomike. Ajo është organizate jofitimpruese dhe jo qeveritare dhe synon të mbeshtesë dhe të bashkëpunojë me të gjithë artistët, krijuesit e filmit të animuar dhe më gjërë

për të përmirësuar zhvillimin e filmit të animuar dhe për të dhënë ndikimin e duhur në këtë zhvillim.

- Për zhvillimin sa më të mirë të këtij objekti ajo do të organizojë edhe programe të përbashkëta me shoqata të tjera që kanë lidhje me veprimtarinë
- Aktivizimin e një grupi të kualifikuar artistësh i cili do të jetë burim i vazhdueshëm konsulence në fushën e filmit dhe të programeve të ndryshëm ku përfshihet animacioni.
- Shoqata me anë të përfaqësuesve të saj do të ndikojë në përzgjedhjen e projekteve fitues të organizuar nga Qendra Kombëtare Kinematografike.
- Përfaqësuesi i kësaj shoqate do të jetë pjestar i bordit artistik të mbledhur nga Qendra Kombëtare Kinematografike; përfaqësuesi duhet të jetë krijues i mirënjohur me një aktivitet të plotë në filmin e animuar, për t'u prezantuar denjësisht në bordin artistik të Qendrës kombëtare Kinematografike.
- Shoqata me anë të krijuesve me përvojë mund të organizojë kurse kualifikimi për të gjithë që shprehin dëshirën për të patur njohuri mbi filmin e animuar, mbi animacionin në 2D dhe 3D (dy dhe tre dimensional).

Selia e shoqates do te jete ne Tiranë, Rruga Aleksandër Moisiu Nr. 76
Kohëzgjatja e saj është me afat të pacaktuar.

Kryetar i shoqatës është zoti. Artan Maku

Kryetari përfaqëson shoqatën në marrëdhënie me të tretët.

Organet kryesore drejtuese të saj janë:

Asambleja e përgjithshme e shoqatës, Bordi drejtues, Grupi i kontrollit të shoqatës,
Kryetari i shoqatës, Sekretari i shoqatës

Burimet financiare të shoqatës vijnë nga kuotizacioni ,donacionet ,dhurata të ndryshme në lekë, valutë, letra me vlere, sende të luajtshme dhe të paluajtshme dhe çdo burim tjetër i lejuar nga ligji ose projektet e përbashkëta si dhe nga të ardhurat e siguruar nga aktivitetet.

Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

